

Data 03.10.2022

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**Objekti i prokurimit:** Ndertim i objektit “Godina e Teatrit Tiranë - Faza I-rë”

**Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 45210000-2, Punime ndërtimi.**

**Vlera e fondit limit:** 1,854,828,635 (një miliard e tetëqind e pesëdhjetë e katër milion e tetëqind e njëzet e tetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

**a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 7, gërma “ç” (sipas Shtojcës 1 te DST).

**b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;**

**c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

**d. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 7, gërma “a”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

#### **Sipas Shtojcës 7 të DST**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

1. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2019, 2020, 2021) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

*Shënim:* Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabel ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabel, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabel përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabel arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabel”.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar).

1. Kopje të deklaratimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2019, 2020, 2021) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 3,709,657,270 (tre miliard e shtatëqind e nëntë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin

*vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

1. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2021 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar për vitin 2022 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB). *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetedeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

#### **Kapaciteti teknik:**

**Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:**

##### **1.Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: 927,414,317.5 (nëntëqind e njëzet e shtatë milion e katërqind e katërbëdhjetë mijë e treqind e shtatëmbëdhjetë pikë pesë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë 5 (pesë) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontrates.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë 5 (pesë) viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: 3,709,657,270 (tre miliard e shtatëqind e nëntë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

*Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

*Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.*

## **1.2 Vlerësimi i përvojës së sukseshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:**

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
    - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
    - Kontratë Sipërmarrje;
    - Situacionin përfundimtar;
    - Aktin e kolaudimit;
    - Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.
  - b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
    - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
    - Kontrate Sipërmarrje;
    - Situacionin përfundimtar;
    - Aktin e kolaudimit;
    - Çertifikatën e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim;
    - Fatura tatimore perkatese.
- 1.3** Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatoreve ekonomik si dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit.
- 1.4** Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

**Argumentimi:** Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: 927,414,317.5 (nëntëqind e njëzet e shtatë milion e katërqind e katërbëdhjetë mijë e treqind

e shtatëmbëdhjetë pikë pesë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë 5 (pesë) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- b.** Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë 5 (pesë) viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: 3,709,657,270 (tre miliard e shtatëqind e nëntë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

*Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

*Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.*

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: “Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.” AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (1.2-1.4), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

**Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.**

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e*

*marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerësimit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.*

Njesia e Prokurimit argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave 1.3 dhe 1.4, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, është konstatuar se Komisionet e Vlerësimit të Ofertave kanë hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa me të drejte të përvojës së ngjashme, në rastet kur në formularet e vlerësimit nuk përcaktohen % e pjesëmarrjes të secilit operator bashkim, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private leshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e përqindjeve), për rrjedhojë është e domosdoshme që Operatorët Ekonomik kur paraqesin kontrata të ngjashme, ku janë pjesë e një bashkimi operatorësh duhet të paraqesin gjithashtu dhe marreveshjen e bashkepunimit dhe prokurën e posaçme ku të përcaktohen % përkatëse.

Në kuadër të vlerësimit të përvojës së ngjashme të secilit operator ekonomik pjesëmarrës, në mënyrë sa me të drejte, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkepunimit; me marreveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo operator ekonomik si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e operatoreve ekonomik ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk sjell kufizim të pjesëmarrjes së operatoreve ekonomik në tender. Te dy këto kërkesa, vendosin në kushte të barabarta dhe u japin mundësi të gjithë operatoreve ekonomik Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit dhe marreveshjet përkatëse të nenkontraktimit nuk janë të plotësuara sipas kërkesave ligjore.

Njesia e Prokurimit ka kërkuar këto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku ndër të tjera përcaktohet se: *”Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.*

## **1. Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:**

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- NP – 1A Punime germimi ne toke
- NP – 2 G Ndërtime civile dhe industriale
- NP – 11A Ndertime per N/stacionet, kabinat e transformatoreve linja TN e te mesem dhe shperndarjen e energjise
- NP – 12A Punime te inxhinierise se mjedisit
- NS – 1 A Punime per prishjen e ndertimeve
- NS – 2 C Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanderi, mirembajtja e tyre
- NS-4 E Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to rifiniture me materiale druri,plastik,metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese etj
- NS – 12 D Impiante Teknologjike, termikedhe te kondicionimit
- NS-14 D Impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radoitelefoni TV etj
- NS-18 A Punime topogjeodezike

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë, të cilat janë vendosur sipas volumeve të punimeve dhe vlerave që përmban Preventivi për cdo zë pune mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
<b>NP-1 A</b>	Punime germimi ne toke	<div style="border: 1px solid black; background-color: #f2f2f2; padding: 5px; text-align: center;"><b>Kategoria Punimeve</b></div> <div style="border: 1px solid black; background-color: #f2f2f2; padding: 5px; text-align: center;"><i>Punime Germimi</i></div>	<b>0-20 milion</b>  Vlera e parashikuar ne preventive per kete kategori punimesh eshte rreth <b>9.469.200 leke</b>

NP-2 G	Ndërtime civile dhe industriale	<b><u>Kategoria Punimeve</u></b>	Mbi 800 milion
		<i>Punime Konstruksioni</i>	Vlera e parashikuar ne preventiv per kete kategori punimesh eshte rreth  1.372.168.015 leke
		<i>Punime Murature</i>	
		<i>Punime Shtresash</i>	
		<i>Punime Dyer Dritare</i>	
		<i>Punime te Ndryshme</i>	
		<i>Punime Tarrace</i>	
		<i>Punime Fasade Xhami e Jashtme dhe e brendeshme</i>	
NP-11 A	Ndertime per N/stacionet,kabinat e transformatoreve linja TN e te mesem dhe shperndarjen e energjise	<b><u>Kategoria Punimeve</u></b>	0-20 milion
		<i>Kabina elektrike</i>	Vlera e parashikuar ne preventiv per kete kategori punimesh eshte rreth  7.127.213 Leke
NP-12 A	Punime te Inxhinierise Mjedisore	<b><u>Kategoria Punimeve</u></b>	0-20 milion
		<i>Punime Gjelberimi</i>	Vlera e parashikuar ne preventiv per kete kategori punimesh 1.250.000 Leke
NS-1 A	Punime per prishjen e ndertimeve	<b><u>Kategoria Punimeve</u></b>	0-20 milion
		<i>Punime Prishje</i>	Vlera e parashikuar ne preventiv per kete kategori punimesh eshte rreth  3.468.600 Leke
NS-2 C	Impiante hidrosanitare,kuzhina, lavanderi, mirembajtja e tyre	<b><u>Kategoria Punimeve</u></b>	51-100 milion
		<i>Rrjeti Furnizimit me Uje</i>	Vlera e parashikuar ne preventiv per kete kategori punimesh eshte rreth  65.180.230 Leke
		<i>Dhoma Teknike</i>	
		<i>Shkarkimet Sanitare</i>	
		<i>Drenazhim+ Shkarkim I Ujerave te Zeza dhe te Shiut</i>	
		<i>Aparatet Sanitare</i>	
		<i>Linjat e Sistemit me Sprinkler</i>	
		<i>Hidrantet e Brendshme dhe te jashtem</i>	
		<i>Sistemi me Aerosol</i>	
		<i>Presurizimi I Shkalleve</i>	



		<i>Evakuimi I Tymrave dhe Ventilimi I parkimit</i>	
<b>NS-4 E</b>	Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to rifiniture me materiale druri,plastik,metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese etj	<b><u>Kategoria Punimeve</u></b>	<b>200-401 milion</b>
		<i>Punime Murature</i>	<b>Vlera e parashikuar ne preventiv per kete kategori punimesh eshte rreth</b>  <b>373.035.046 Leke</b>
		<i>Punime Shtresash</i>	
		<i>Pune te Ndryshme</i>	
		<i>Punime tarrace</i>	
		<i>Punime fasade Xhami te jashtme e te brendeshme</i>	
		<i>Punime Sheshi dhe oborri</i>	
<b>NS-12 D</b>	Impiante Teknologjike, termikedhe te kondicionimit	<b><u>Kategoria Punimeve</u></b>	<b>101-200 milion</b>
		<i>Impianti HVAC</i>	<b>Vlera e parashikuar ne preventiv per kete kategori punimesh eshte rreth</b>  <b>171.482.559 Leke</b>
		<i>Sistemi i Ventilimit, Detektimit te CO dhe Nxjerrjes se Ajrit</i>	
<b>NS-14 D</b>	Impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radoitelefoni TV etj	<b><u>Kategoria Punimeve</u></b>	<b>101-200 milion</b>
		<i>Instalimet e Ndricimit</i>	<b>Vlera e parashikuar ne preventiv per kete kategori punimesh rreth</b> <b>135.283.709 Leke</b>
		<i>Instalimet e Fuqise</i>	
		<i>Kanalina Metalike</i>	
		<i>Instalimet e Rrjetit Data</i>	
		<i>Instalimet e Sistemit te Alarmit te Zjarrit</i>	
		<i>Instalimet e Sistemit CCTV</i>	
		<i>Instalimet e Sistemit te Alarmit Zanor</i>	
		<i>Instalimet e Sistemit te ndricimit te Emergjences</i>	
		<i>Instalimet e Sistemit dhe te Mbrojtjes Atmosferike</i>	
		<i>Instalimi I Sistemit te Kontrollit te Aksesit</i>	
		<i>Infrastruktura e Jashtme Elektrike</i>	
		<i>Instalimi I Sistemit te Tokezimit te Punes</i>	
		<i>Instalimi I Sistemit te tokezimit per Pajisjet Audio</i>	
<i>Sistemi qendror kompjuterik</i>			

NS-18 A	Punime Topogjeodozike	<b><u>Kategoria Punimeve</u></b>	
		<i>Punime topografike ne matje dhe rilevime per realizimin e objektit I cili ne kompleksitetin arkitektonik eshte nje veper relativish e veshtire per shkak te formave te vecanta arkitektonike dhe kerkohet anagazhim me pajisje dhe staf te specializuar per realizimin e rilevimeve topografike</i>	

*N.P-1A (Punime gërmimi në tokë)*

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me gërmime në tokë, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

*N.P-2G (Ndertime civile dhe industriale)*

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me ndertime civile dhe industriale, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

*N.P-11A (Ndertime per N/stacionet,kabinat e transformatoreve linja TN e te mesem dhe shperndarjen e energjise)*

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me ndertime per N/stacionet,kabinat e transformatoreve linja TN e te mesem dhe shperndarjen e energjise, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

*N.P-12 A (Punime të inxhinierisë së mjedisit)*

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me Punime të inxhinierisë së mjedisit, vepra kullimi e vaditje, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

*N.S-1A (Punime për prishjen e ndërtimeve)*

Në preventivin e punimeve janë parashikuar zëra pune qe kane te bejne me prishjen e strukturave te betonit, te cilat shtojne te nevojeshme qe Operatori Ekonomik te jete i licensuar per kategorie N.S-1A.

*N.S-2C (Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanderi, mirembajtja e tyre)*

Në preventivin e punimeve janë parashikuar zëra pune qe kane te bejne me punime hidrosanitare etj, te cilat shtojne te nevojeshme qe Operatori Ekonomik te jete i licensuar per kategorie N.S-2C.

*N.S-4E (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to rifiniture me materiale druri, plastike, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese)*

Në preventivin e punimeve janë parashikuar zëra pune qe kane te Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to rifiniture me materiale metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese, te cilat shtrojne te nevojeshme qe Operatori Ekonomik te jete i licensuar per kategorie N.S-4E.

*N.S-12D (Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit)*

Në preventivin e punimeve janë parashikuar zëra pune Sistem Chiller, etj, të cilat shtrojnë të nevojshme që Operatori ekonomik të jetë i licensuar për kategorinë N.S-12D.

*N.S-14D (Impiante te brendeshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj)*

Në preventivin e punimeve janë parashikuar zëra pune Impiante te brendeshme, elektrike, telefoni, etj , të cilat shtrojnë të nevojshme që Operatori ekonomik të jetë i licensuar për kategorinë N.S-14D.

*N.S-18A (Punime topogjeodezike)*

Duke qene se në projekt e preventiv janë parashikuar punime të natyrës topogjeodezike dhe është e nevojshme zotërimi i kësaj pike license.

2. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklaroje se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:
  - a) Librezë pune;
  - b) Kontratë pune e vlefshme;
  - c) Diplomë.

*(Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet te përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklaroje se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe te jetë i pranishem gjate gjithë kohes qe do te kryhen punimet ne objekt ne varesi te vleres se preventivit te punimeve qe ka marre persiper sipas përqindjes se bashkepunimit).*

**Argumentimi:** *Së pari*, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

*Së dyti*, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik te sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit., gjithashtu jemi në kushtet e parashikuara në pikën 2.1 të Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” ku përcaktohet se: “Për vepra me vlerë të plotë, të preventivuar mbi 30,000,000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjesi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimit”.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e

*dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohe të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohe ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.*

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

3. Një punësim mesatar i të paktën **220** (dyqind e njet) personave, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave vërtetuar me:
  - a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar.
  - b. Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen e fundit te deklaruar, shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej **220 punonjësish**, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të cdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatimit të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda 27 muajve kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës, mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shpëputje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në

konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t'u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" sipas së cilës: "Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës".

4. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
  - 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
  - 1 (një) Inxhinier Elektrik
  - 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder/Gjeomatik
  - 1 (një) Inxhinier Gjeolog
  - 1 (një) Inxhinier Mekanik
  - 1 (një) Inxhinier Mjedisi

**Argumentimi:** Autoriteti Kontraktor argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c".

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtimit, elektroteknik, mjedisi, hidroteknik, topograf, gjeolog, arkitekt është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në

bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës 2.4, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin ,stafin mbeshtetes si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NP - 1, NP - 2, NS - 1, NS - 4**, eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinierit të Ndërtimit**. Ne kete veper parashikohet ndertimi i strukturave beton arme komplekse, themeleve te thella dhe strukturave mbajtese nen presion horizontal (Gropa themelit dhe perforcimi me mure dhe pilota), si dhe punime te natyres se rifiniturave teknike.
  - Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NS - 2**, eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinierit Hidroteknik**. Ne kete veper parashikohen nderhyrje te konsiderueshme ne ndertimin e impianteve sanitare dhe mbrojtjes nga zjarri.
  - Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NP - 11, NS - 14** eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinierit Elektrik**. Ne kete veper nje pjese te rendesishme zene punimet per instalimet elektrike.
  - Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NS 18** eshte e nevojshme prezenca e një **Inxhinier Gjeodet/Topograf/**, pasi çdo matje që do të bëhet në funksion të objektit të prokurimit kërkon domosdoshmërisht praninë e këtij Inxhinieri.
  - Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NP - 1, NP – 2**, eshte e nevojshme prezenca e një **Inxhiner Gjeolog**, kjo duke mare ne konsiderate dhe numrin e madh te shpimeve me sonda per realizimin e pilotave dhe mureve mbajtese si masat mbrojtese per faqet e gropes se germuar qe ndodhet ne nje thellesi te konsiderueshme mbi 10 m dhe duhet me patjeter gjate realizimit te kemi prezencen e gjeologut gjate gjithë kohes se realizimit te punimeve te germimit dhe themeleve e strukturave mbajtese te faqeve anesore te gropes se germimit.
  - Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NS – 12**, eshte e nevojshme prezenca e **Inxhiner Mekanik**, pasi kjo veper parashikon realizimin e sistemeve HVAC.
  - Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NP - 1, NS – 1, NP - 12** eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinier Mjedisi**. Ne kete veper parashikohen volume te konsiderueshme gemimi ne thellesi mbi 10m, te cilat kane ndikim te drejtperdrejt dhe ne mjedisin perreth duke qene se vepra realizohet ne zone mjaft te populluar, si dhe gjithashtu do te kemi parashikimin e gjelberimit dhe punimeve te tjera mjedisore.
5. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, te perfshire ne licensen e shoqerise ose pajisur me license individuale, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë ne listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajit e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, si më poshtë:

- 2 (dy) Inxhinier Ndertimi Profili Strukturist
- 2 (dy) arkitekt
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik
- 2 (dy) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder;
- 1 (një) inxhinier Mjedisi;
- 1 (një) inxhinier Gjeolog;
- 1 (një) inxhinier Gjeoteknik;

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar me lart sipas pikes 7, është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve, nga ku përcaktohet profili inxhinierik i nevojshem për ekzekutimin e kontratës si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST.

Njësia e Prokurimit duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve si dhe referuar në preventivin e Punimeve është e domosdoshme të plotësohet kërkesa për:

**2 (dy) Inxhinier ndertimi me profilin Struktura,** pasi punimet strukturore zene volumnin me të madh të punimeve në veprë dhe janë komplekse për shkak të formës arkitektonike të objektit.

**2 (dy) Arkitekte,** Për shkak të rëndësisë së veprës, formës së vecantë arkitektonike, detajet e rifiniturave për këtë lloj kategorie veprë kërkojnë domosdoshmërisht prezencën e një stafi arkitektësh me qëllim mbarevajtjen dhe zbatimin me rigorozitet të detajeve të rifiniturave arkitektonike dhe jo vetëm.

**1 (nje) Inxhinier Elektrik,** Punimet elektrike në veprë zene një hapësirë të konsiderueshme në volumnin total të punimeve

**1 (nje) Inxhinier Mekanik,** pasi kemi realizimin e punimeve mekanike të sistemeve teknologjike, ngrohje ftohje ventilim,

**1 (nje) Inxhinier Hidroteknik,** Punimet Hidroteknike të impianteve të brendshme të furnizimit me ujë, sanitare, të shkarkimeve etj. zene në veprë një hapësirë të konsiderueshme në volumnin total të punimeve

**2 (dy) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder,** Punimet Topogjeodezike janë të një rëndësie të vecantë për këtë objekt pasi rilevimi në plan dhe në altimetri për objektin do të jetë një proces i vazhdueshëm në çdo ditë pune, për shkak të formës arkitektonike dhe strukturore të objektit i cili gjeometrikisht nuk është i rregullt në plan dhe në altimetri por ka thyerje të shumta arkitektonike.

**1 (nje) Inxhinier Mjedisi,** pasi punimet që kanë ndikim në mjedis janë prezente. Në preventivin e punimeve përveç punimeve të drejtperdrejta si janë sistemimi me gjelberim i sheshit të tetrit, oborrit etj. janë dhe punimet jo të drejtperdrejta por me ndikim të konsiderueshëm në mjedis si punimet e germimit etj.

**1 (nje) Inxhinier Gjeolog.** Për shkak se vepra ka punime nentokesore pasi ka kat nentoke dhe praktikisht thellesia e germimit referuar projektin shkon në rreth 10m dhe gjithashtu për të ruajtur

gropen e germimit perdoren struktura per presion horizontal si perde me pilota, pajantime etj eshe e domosdoshme prezenca e inxhinierit gjeolog me qellim vleresimin hap pas hapi te kesaj faze te punimeve per percaktimin e sakte te vetive te dherave qe do te shfaqen gjate germimeve.

**1 (nje) Inxhinier Gjeoteknik.** Per shkak se objekti paraashikohet te germohet ne nje thellese prej me shume se 10 m nga siperfaqja e tokes, projekti parashikon realizimin e strukturave mbrojtese me pilota dhe pajantime, si dhe pilotat me jet grouting shoqeruar me mure b/a dhe masa te ndryshme gjeoteknike per te arritur sigurine e gropes se themelit si dhe sigurine e objekteve fqinje me projektin ne fjale konkretisht, Ministrite prane godines, Nje objekt shume katesh (13 kate) pedonalen e Tiranës etj, fuknsinin e monitorimit dhe te vleresimit te bashkeveprimit strukture truall e mbulon inxhinieri gjeoteknik.

6. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme, diplome/deshmi përkatëse leshuar nga institucione te akredituara nga autoritetet pergjegjese shtetore, dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve), si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajit e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, si më poshtë:
- 2 (dy) Teknik ndertimi
  - 1 (nje) Teknik mekanik
  - 2 (dy) punonjes hidraulike
  - 3 (tre) punonjes elektriciste;
  - 2 (dy) punonjes mekanike
  - 2 (dy) punonjes bojaxhi
  - 2 (dy) punonjes murator
  - 2 (dy) punonjes saldatore
  - 2 (dy) punonjes hekurkthyes
  - 2 (dy) punonjes karpentiere
  - 2 (dy) punonjes pllakashtrues
  - 2 (dy) punonjes hidroizolues

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes qe do te realizohen,si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve te percaktuar ne specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/deshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse



shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik. Certifikimet/diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se.

**Ne lidhje me 2 (dy) Teknik ndertimi** prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike .

**Ne lidhje me 1 (nje) Teknik mekanik** kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.

**Ne lidhje me 2 (dy) hidroteknik** kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.

**Ne lidhje me 3 (tre) punonjes elektriciste** kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.

**Ne lidhje me 2 (dy) punonjes mekanike** kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.

**Ne lidhje me 2 (dy) punonjes bojaxhi** kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.

**Ne lidhje me 2 (kater) punonjes murator** kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.

**Ne lidhje me 2 (dy) punonjes saldator** kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.

**Ne lidhje me 2 (dy) punonjes hekurkthyes** kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.

**Ne lidhje me 2 (dy) punonjes karpentier** kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.

**Ne lidhje me 2 (dy) punonjes pllakashtrues** kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.

**Ne lidhje me 2 (dy) punonjes hidroizolues** kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.

7. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht **8 (tete) punonjes eskavatoriste, 4 (kater) punonjes automakiniste dhe 4 (kater) punonjes Buldozeriste** për të cilët duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, Dëshmi e Aftësisë Profesionale (të vlefshme) lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. Në rastin kur punonjësit e sipërcituar janë të kontraktuar me kontratë pune respektivisht për mjetet e marra me qera, nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Njësia e Prokurimit duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve; makineritë që do të kërkohen për realizimin e punimeve (Shtojca 8) si dhe Preventivin e Punimeve shtron nevojën që Ofertuesit

të kenë të punësuar Manovrator me qëllim realizimin e kontratës me sukses. Numri i këtyre punonjësve është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Gjithashtu me qëllim nxitjen e garës është përcaktuar rasti përjashtimor ku për Manovratorët që janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.

Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmimeve të Aftësive Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë :

- a) eskavator gjermimi e ngarkimi dherash : të të gjitha llojeve si dhe fadromat e të gjitha llojeve (me goma dhe me zinxhirë), manovratorëve u jepet dëshmi për **Eskavatorist**;
- b) buldozer gjermimi, shtyrje, nivelimi e ngjeshje dherash apo shpim toke : të gjithë llojet e traktorëve me thikë (ruspë), ose që tërheqin skreper, grejder apo nivelues, rul vibrues, shtruese asfalto-betoni, skreperët, grejderët dhe niveluesit kur janë vetëlëvizës, të gjithë llojet e traktorëve, me pajisje shtesë për ngritjen e peshave, shpimin e puseve etj., manovratorëve u jepet dëshmi për **Buldozerist**.
- c) automjete për përdorim të veçantë (APV) sipas pikës “g”, të nenit 54, të Kodit Rrugor, makineri ndërtimi mbi bazë automjeti : autovinça, autobetonierë, autopompa betoni, autobitumatriçe, autosonda, autotokmak, manovratorëve u jepet dëshmi për **Automakinist**.

8. Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë").*

**Argumentimi:** AK argumenton se kërkesa për *Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, “*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*“, sipas të cilit: „*Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....*“.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte,

vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

9. Operatori/et ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) punonjës specialist “Ekspert Zjarrefikes ne fushen e mbrojtjes nga Zjarri dhe per shpetim” në përputhje me Ligjin Nr. 152/2015 "Për sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certificate dhene nga Drejtoria MZSH, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës " Ekspert Zjarrefikes ne fushen e mbrojtjes nga Zjarri dhe per shpetim").*

**Argumentimi:** AK argumenton se kërkesa për *Ekspert Zjarrefikes ne fushen e mbrojtjes nga Zjarri dhe per shpetim* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 49, pika 4 të Ligjit Nr. 152/2015, “Për sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin“, *ku citohet se : ”Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së jep certifikatë për personat fizikë e juridikë për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit zjarrfikës privat, në bazë të kriterëve të veçanta të miratuara me udhëzim të ministrit”.*

Theksojmë se, për shkak të natyrës së punimeve që kryhen: punime elektrike, saldimi etj të cilat kanë potencial të shkaktit të aksidenteve me rrezik zjarri kërkohet një specialist për të bërë planin e masave dhe evakuimin në raste aksidentesh ndaj zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domozdoshme prania e **1 (nje) specialist Ekspert Zjarrfikës ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin.**

10. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet elektrike, tuba, hidroizolues. Per materialet e kerkuara OE duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten çertifikatë/deklaratë konfirmiteti CE, certifikatat e cilesise ose raportet e testimi nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 8, si dhe”, në bazë të nenit 45, pika 1 të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kjo kerkese është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshem Teknik dhe ploteson specifikimet e kerkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kerkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm. Ne menyre qe Autoriteti Kontraktor te verifikojë qe specifikimet teknike te paisjeve te propozuara nga operoret

ekonomik plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: çertifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilësisë ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara në Specifikimet teknike.

Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet/shërbimet që parashikohen të realizohen në preventive si dhe për shkak të interesit të lartë që ka objekti duhet të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira evropiane. Prandaj e gjujkojmë të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira evropiane, që OE ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit.

Për të siguruar këtë gjë, por njëkohësisht dhe për të detyruar ofertuesit e mundshëm në zbatimin e këtyre standarteve ka parashikuar kërkesën e mësipërme vetëm për disa nga mallrat kryesorë me që do të përdoren në këtë objekt konkretisht OE duhet të japin dhe paraqesin në mënyrë të detajuar karakteristikat teknike të mallrave të përfshirë në dokumentat e tenderit, karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga projektuesi.

Për këtë, ofertuesit duhet të deklarojnë produkte të pajisura me çertifikatë konformiteti CE/certifikate cilësie etj. Me anë të venies në dispozicion në fazën e ofertimit dokumentat si autorizim-marreveshje angazhimi, skeda teknike, certifikata cilësie, certifikata konformiteti, raporte testimi ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë prodhim sipas kërkesave të projektit. Plotësimi i kërkesës sipas pikës 9, garanton Autoritetin Kontraktor për cilësinë dhe standartet e larta ndërkombëtare dhe të përditësuara sipas teknologjive të reja dhe bashkëkohore.

11. Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për 27 (njëzet e shtatë) muaj kalendarikë.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 3.

13. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 9001:2015.

b) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 14001-2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 14001-2015.

c) Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 45001-2018.

d) Çertifikatën e menaxhimit të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor ISO 39001-2012 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 39001-2012.

e) Çertifikatën e menaxhimit të energjise ISO 50001-2011 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, certifikata ISO 50001-2011 do të paraqitet nga Operatori ekonomik që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërave të punimeve elektrike sipas preventivit).

**Argumentim:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “d” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtarë, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci

extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 39001:2012 është standart ndërkombëtar, i cili përcakton kërkesat për sistemin e menaxhimit të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor (RTS). AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 39001:2012 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të jetë në përputhje me sistemin e qarkullimit rrugor, si dhe të reduktojë apo përjashtojë rreziqet e humbjes së jetës dhe plagosjeve të rënda në aksidentet e qarkullimit rrugor. Duke marrë shkas dhe nga natyra e objektit të prokurimit ku mundësia për ngarkesën e trafikut rrugor është e lartë, me qëllim minimizimin e këtij risku, është e domosdoshme që Ofertuesit të jenë të pajisur me ISO 39001:2012.

ISO 50001-2011 është një standard i ri i konceptuar për të asistuar kompanitë në zbatimin e një sistemi të menaxhimit të përshtatshëm për identifikimin dhe minimizimin e konsumit energjetik. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 50001:2011 me qëllim që veprimtaria e ushtruar (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi), të reduktojë kostot energjetike të kompanive, emisionet e gazrave serë (GHG) dhe impaktet e tjera në mjedis. Në Preventivin e punimeve parashikohen zëra elektrik, ku zbatimi i tyre kërkon që Ofertuesi të jetë i pajisur me Certifikatë ISO 50001-2011. Në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.

Për sa më lart, Njësia e Prokurimit, gjykon se, kjo kërkesë në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik duhet të përmbushet nga Shoqëria e cila referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë zerat elektrike të pasrashikuara sipas Preventivit.

Njësia e prokurimit gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara sipas pikës 10 gërma “a”- “d”, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

**12. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:**

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	copë	3	Në pronësi ose me qera
2.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 10 - 20 ton	copë	4	Në pronësi ose me qera
3.	Kamionçinë me kapacitet mbajtës 3.5 - 5 ton	copë	4	Në pronësi ose me qera
4.	Autovinc minimumi 5 Ton	copë	2	Në pronësi ose me qera
5.	Eskavator me zinxhir me kovë 0.25 m3	copë	4	Në pronësi ose me qera
6.	Vinç kullë 6 – 10 ton	copë	2	Në pronësi ose me qera

7.	Pompë suvatimi	copë	2	Në pronësi ose me qera
8.	Elektroorgano	copë	2	Në pronësi ose me qera
9.	Grejder	copë	1	Në pronësi ose me qera
10.	Rrul vibrues	copë	2	Në pronësi ose me qera
11.	Vibrator thellësie	copë	4	Në pronësi ose me qera
12.	Vibrator sipërfaqësor	copë	4	Në pronësi ose me qera
13.	Autopompë betoni	copë	2	Në pronësi ose me qera
14.	Sondë me fuqi shpimi për diametër 800 mm dhe thellësi 20 m	copë	2	Në pronësi ose me qera
15.	Autobetonierë	copë	4	Në pronësi ose me qera
16.	Fadromë me goma	copë	2	Në pronësi ose me qera
17.	Autobot uji	copë	2	Në pronësi ose me qera
18.	Zyra lëvizëse kantieri	copë	2	Në pronësi ose me qera
19.	Autovinc me kosh për punime në lartësi	Copë	1	Në pronësi ose me qera
20	Skeleri	m2	3000	Në pronësi ose me qera

- a.** Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit: (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- b.** Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- c.** Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- d.** Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.
- e.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

- f. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mesiperme eshte vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nepermjet ketyre kerkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qellim permbushjen me sukses te kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

**Shënim:** Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.